



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 27 datë 25.07.2019**

**MBI**

**“VIJIMIN E PROCEDURËS TË ZHVILLIMIT TË TENDERIT PUBLIK PËR  
DHËNIEN NË PËRDORIM TË FREKUENCAVE NË BREZIN 800 MHZ,  
SPEKTRI I PAALOKUAR”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir Zela	Kryetar
2. Znj. Edlira Dvorani	Anëtar
3. Znj. Ketrin Topçiu	Anëtar
4. Znj. Xhoana Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 25/07/2019, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues, si dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***“Vijimin e procedurës të zhvillimit të tenderit publik për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 800 MHz, spektri i paalokuar”.***

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 68 e vijues, të Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Pika 1, e nenit 9, te Ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital – Dividentit” (ligji nr. 34/2017);
3. Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Praktikën dokumentare për dhënien në përdorim të bllokut A2 të frekuencave 800 MHz;
2. Projekt-Vendimin e formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacionin shoqërues të Projekt-Vendimit (Relacioni);

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi këtë çështje, e gjithashtu bazës ligjore të lartpërmendur,

### V Ë R E N:

#### I. Rrethanat e Çështjes:

1. Në referim të pikës 2, të nenit 68, të Ligjit 9918/2008, si dhe të dispozitave të Ligjit nr. 34/2017, me qëllim përmbushjen e politikave të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka kërkuar zyrtarisht me shkresë Nr. 688 Prot., datë 15.02. 2018 “Për fillimin e procesit të këshillimit publik për frekuencat në brezin 800 MHz (792-860MHz), subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara”, inicimin e procesit të këshillimit publik për frekuencat në brezin 800 MHz (792-860MHz), subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara.

2. Pas administrimit të kërkesës së Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.10 datë 15.02.2018, AKEP ka miratuar nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, analizimit dhe vlerësimit të komenteve të sjella nga palët, si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore shprehur në nenin 68, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, AKEP përgatiti propozimin për Ministrin, në lidhje me procedurën e konkurrimit publik, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre.

3. Pas miratimit të Ministrit për vijimin e procedurës, AKEP zhvilloi procesin e dhënies së autorizimit individual, konform nenit 69 të Ligjit 9918/2008, në përfundim të të cilit është shpallur fitues për bllokun A2 të brezit 800 MHz, 1x10 MHz i çiftuar, saktësisht për frekuencat 801-811 MHz (10 MHz) i çiftuar me 842-852 MHz (10 MHz), sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a.”, ndërkohë që për dy blloqet e tjera: A1 të brezit 800 MHz, 1x10 MHz i çiftuar, saktësisht për frekuencat 791-801 MHz (10 MHz) i çiftuar me 832-842 MHz (10 MHz) dhe bllokun A3 të brezit 800 MHz, 1x10 MHz i çiftuar, konkretisht për frekuencat 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz), nuk u paraqitën oferta nga operatorë vendas apo dhe të huaj.

4. Sa më sipër, AKEP vlerëson se duhet të vijojë procedurat ligjore për akordimin e blloqeve të tjerë të frekuencave në këtë brez, me qëllim përdorimin eficient të tyre duke mbajtur parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore, ndërkohë që dhënia në përdorim e tyre nga AKEP-i bëhet në bazë të parimit të objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit.

## Këshilli Drejtues i AKEP

pasi shqyrtoi çështjen, në referim me bazën ligjore të lartpërmendur, si dhe në vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave;

### II ARSYETON:

4. Në kuptim të nenit 68 të Ligjit 9918/2008, AKEP ka kompetencën dhe detyrimin njëkohësisht që të fillojë një proces këshillimi publik për frekuenca specifike, subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara, edhe me kërkesë të ministrit.

Duke qënë në kushtet kur:

- a) AKEP ka përmbushur e kryer me sukses një proces këshillimi për frekuencat e brezit 800 Mhz;
- b) AKEP ka marrë/përftuar mendimet e palëve të interesuara lidhur me kufizimin e të drejtës për dhënien në përdorim të këtij brezi;
- c) AKEP ka shteruar plotësisht hapat procedural që shpreh neni 68 i Ligjit nr. 9918/2008, për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 800 Mhz, pasi një dispozitë e tillë synon, sikurse u shpreh dhe me lart, të lidhë ngushtësisht përdorimin eficient të brezit të frekuencave, si nje pasuri kombëtare, me përfitim apo përfshirjen e palëve të interesuara nëpërmjet një procesi konsultimi publik.
- d) AKEP, nëpërmjet procedurës së këshillimit publik të zhvilluar në muajin shkurt të vitit 2018, për dokumentin “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)”, ka ezauruar tashmë fazat procedurale të zhvillimit të konsultimit publik, ashtu dhe sikurse përcakton neni 68 i ligjit 9918/2008.
- e) Pas kryerjes së konsultimit publik, shkresa nr. 7481, date 22.06.2018 e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, përcakton qartë vijimin e procedurës të dhënies në përdorim të të gjithë brezit 800 MHz nëpërmjet procedurës së konkurimit publik, duke përcaktuar llojin e procedurës që do të kryhet nga AKEP, ndarjen e brezit sipas modelit të propozuar nga AKEP, numrin maksimal të AI që do të lëshohen në përfundim të procedurës konkurruese në fjalë, kohëzgjatjen e vlefshmërisë së tyre, mënyra e pagesës dhe natyrisht edhe çmimin referencë.

KD i AKEP, konsideron determinante gjithashtu edhe:

- a) Të kërkojë vlerësimin dhe miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë sa i përket vijimit të dhënies në përdorim të frekuencave në brezin 800 Mhz, meqënëse fazat që i paraprijnë hapjes së procedurës së tenderit janë ezauruar plotësisht dhe nuk ka të dhëna për ndryshime të situatave aktuale të tregut apo shprehjes së interesave nga palë të interesuara, pasi eventualisht brezi në fjalë vazhdon të mbetet mjaft atraktiv për aktorët/operatorët vendas por dhe të huaj.
- b) Në vëmendje të gërmës më sipër, KD i AKEP arsyetoi me kujdes se rinisja e një konsultimi publik për të njëjtin brez frekuencash dhe pothuajse në të njëjtat kushte dhe rrethana operationale që u zhvillua herën e parë,

referuar nenit 68, të Ligjit 9918/2008 kërkon një periudhë kohore jo më pak se tre muaj.

- c) KD vlerëson seriozisht se egziston mundësia ligjore që mund dhe duhen të shmangen vonesa të pajustificuara të procedurave të konkurrimit publik për dhënien në përdorim të brezit të frekuencave 800 MHz, ndër të tjera dhe në funksion të mirë menaxhimit të këtij brezi, i cili referuar nenit 66 të ligjit 9918/2008 konsiderohet pasuri kombëtare.
- d) Gjithashtu KD vlerëson se përsëritja e konsultimit publik, do të krijonte vonesa të pajustificuara në arkëtimin nga buxheti i shtetit të ardhurave të konsiderueshme në pikëpamjen financiare.

### **III Në përfundim, KD i AKEP vlerëson se:**

- a) në kushtet kur kufizimi i të drejtave për dhënien në përdorim të frekuencave është përcaktuar në bllok për brezin 800 MHz,
- b) gjithashtu, në terma të vlerësimit ekonomik frekuencat e paalokuara vazhdojnë të mbeten atraktive për operatorët/sipërmarrësit prezent në tregun e komunikimeve elektronike,
- c) e se në aspektin procedural/ligjor procesi i konsultimit publik konsiderohet tashmë i kryer,

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë propozimin për Ministrin për vijimin e procedurës së tenderit publik lidhur me dhënien në përdorim të frekuencave të brezit 800 MHz, spektri i paalokuar.
2. Procedura e tenderit publik për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 800 MHz, spektri i paalokuar, do të zhvillohet për:
  - bllokun A1 të brezit 800 MHz, 1x10 MHz i çiftuar, konkretisht për frekuencat 791-801 MHz (10 MHz) i çiftuar me 832-842 MHz (10 MHz)
  - bllokun A3 të brezit 800 MHz, 1x10 MHz i çiftuar, konkretisht për frekuencat 811-821 MHz (10 MHz) i çiftuar me 852-862 MHz (10 MHz), konkretisht:
    - Spektri i disponueshëm, i paalokuar, 2x20 MHz;
    - Madhësia e bllokut 1x10 MHz i çiftuar, për secilin bllok A1 dhe A3;
    - Guard band prej 1MHz me fillim 790 MHz;
    - FDD downlink fillon në 790 MHz dhe FDD uplink fillon në 832 MHz;

3. Realizimin e Procedurë e Hapur, sikurse përcakton VKM nr.1252, datë 10.09.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar, me raunde sipas skemës së propozuar.
4. Numrin maksimal i Autorizimeve Individuale për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 790-862 MHz të jetë 2(dy), për të drejtë përdorimi bllok i çiftuar 10 MHz.
5. Vlerën minimale të pranueshme për ofertuesit për dhënien e një autorizimi individual për përdorimin e frekuencave në brezin 800 MHz për bllok 10MHz i çiftuar, të jetë jo më pak se 7.44 milion Euro.
6. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit Individual të jetë 15(pesëmbëdhjetë) vjet. Koha e fillimit të shfytëzimit të frekuencave të jetë jo më vonë se dy muaj nga data e pajisjes me Autorizim Individual.
7. Kushtet teknike për Autorizim Individual, të aplikohen përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave.
8. Kriter i vlerësimit të ofertave të vlefshme, të jetë çmimi i ofertës sipas formulës së mëposhtme:  
 $P_{ox} = 100 \times C_{ox} / C_{max}$   
 $P_{ox}$  – [pikët e një oferte të dhënë (x) në varësi të çmimit të ofertës]  
 $C_{ox}$  – [Çmimi i ofertës së dhënë]  
 $C_{max}$  - [Çmimi maksimal i ofertave]
9. Mënyrën e pagesës: Pagesë e plotë në momentin e dhënies së autorizimit individual.

Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ilir ZELA</b>	<b>Edlira DVORANI</b>	<b>Ketrin TOPÇIU</b>	<b>Xhoana LILAJ</b>